



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Republika e Kosovës;
Kuvendi i Komunës së Junikut;
Nr: 02/14/22;
Datë: 30.06.2022 .

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr. 03/L-040, GZRK numër 28/2008); nenit 22 paragrafi 22.1 pika 4) të Statutit të Komunës së Junikut (vendimi i Kuvendit të Komunës së Junikut numër 001/26) dhe Qarkores Buxhetore 2020/01 për Komunat, **Kuvendi i Komunës së Junikut** në mbledhjen e tij të rregullt të mbajtur më 29.06.2022 nxjerrë:

V E N D I M

për

miratimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023 - 2025

I. Me këtë vendim miratohet Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) në kufijtë preliminar të buxhetit komunal të Komunës së Junikut për periudhën 2023 – 2025 e propozuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Junikut, me një kërkesë për përkrahje me mjete buxhetore shtesë të cilat janë pjesë e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2023-2025.

II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KABK) 2023 -2025.

III. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Komunës së Junikut.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve;
- Kryetari i Komunës së Junikut;
- Shërbimi i kuvendit të komunës; dhe
- Arkivi i komunës.

Kuvendi i Komunës së Junikut

z. Shpejtim Gacaferi



kryesues